



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 168/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes flamujve partiak mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5100 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 06.10.2013, nga LDK-ja, me të cilën pretendohet se me 06 tetor 2013 në Lipjan subjekti politik PDK ka vendosur flamujt e subjektit politik të PDK-së mbi rrugët publike të qytetit. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore konkretisht dispozitat e nenit 4.1 pika b). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 06.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013, në ora 16:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se fotot e ofruara si nuk janë të mjaftueshme dhe se nuk mund të konsiderohen si prova, dhe se dispozita në të cilën janë mbështetur pretenduesi i ankesës nuk përcaktojnë edhe shtyllat e ndriçimit si objekte ku nuk mund të vendosen shenjat dhe posterat e ndryshëm. Andaj subjekti politik PDK kërkon që ankesa në fjalë të hudhet si e pa bazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si flamujt e subjektit politik PDK janë të vendosura mbi rrugët publike të trafikut, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Pretendimet e theksuara në përgjigje të ankesës nga subjekti politik PDK, se vendosja e posterave në shtylla elektrike nuk përcaktohet me ligj, kjo çështje nuk është kontestuese por pretendimet e parashtruar në ankesë nga subjekti politik LDK se është bërë shkelje e kodit të mirësjelljes me vendosjen e flamujve mbi rrugë publike janë të bazuara nga provat e ofruara.

Prandaj PZAP-i duke marrë parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës dhe dy fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore janë të bazuar ashtu që subjekti politik PDK është përgjegjës për veprimet e tilla konform nenit 32.5 të LZP-së. Meqenëse subjekti politik PDK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për evitimin e shkeljes së supozuar përveç thënie në përgjigje të ankesës të cilës nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi, andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 168/2013 më datën 09.10.2013.



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*